REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr. 486 REP.
Nr. 122 KOL.

TAKSA ... U PAGUA

## MARREVESHJE SIGURUESE

*(Mbi Barrësimin e Kuotave te Shoqerise)*

Sot me date 01.02. 2018 (dymije e tetembedhjete) para meje noterit/noteres XH. B. BRAHAJ, anetar/e ne Dhomen e Noterise Korce, me zyre ne adresen: Rr. F. Qemali, Korce, u paraqiten personalisht per te redaktuar kete kontrate palet:

I. **KREDIDHENES / BARREMARRES: BANKA KOMBETARE TREGTARE Sh.a** - **Sh.a – Dega Rruga e Elbasanit**, regjistruar ne Gjykaten e Tiranes me Vendimin nr 17469 date 23.07.1997, ketu e me poshte do te quhet **"Banka"**, perfaqesuar nga:

1) **Z. Sokol Petrit KACILA**, i datelindjes 23.04.1978 shtetas Shqiptar, mbajtes i dokumentit te identifikimit: karte identitetime **Nr.** Nr 028753191, ne cilesine e Drejtuesit **te Deges se BKT-se –Rruga Elbasanit.**

2) **Znj. Elvira Bajram PRODA,** e datelindjes 30.10.1981, shtetase Shqiptare, mbajtese e dokumentit te identifikimit: karte identitet**ime Nr.** 028750043, ne cilesine e Drejtueses se Marketingut **e Deges se BKT-se Rruga Elbasanit.**

I. BARREDHENES:

1. **Shoqeria "Albesol" sh.p.k.,** regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit (QKB) ne daten **07.11.2014** me **Numer Unik Identifikimi (NUIS) L42307014K**, me zyre qendrore te shoqerise ne adresen: Njësia Administrative Baldushk, Zona Fushas, Lagjja Harazi, Rruga Fushas, Godinë Private me Nr.Pasurie 64/3, Magazinë 1 Katëshe Nr.2, Tirane qe me poshte do te quhet **"Kredimarres"**, e cila perfaqesohet nga:

- **Znj. Elona Luan Pulti,** e datelindjes **12.12.1972**, shtetase **Shqiptare**, mbajtese e dokumentit te identifikimit **Karte Identiteti** me **Nr. 025326972** dhe **Nr. Personal H26212035K**, banuese ne adresen TIRANE, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, me cilesine e ortakut te vetem te shoqerise.

2. **Znj. Elona Luan Pulti,** e datelindjes **12.12.1972**, shtetase **Shqiptare**, mbajtese e dokumentit te identifikimit **Karte Identiteti** me **Nr. 025326972** dhe **Nr. Personal H26212035K**, banuese ne adresen TIRANE, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, me cilesine e ortakut te vetem te shoqerise.

### *Neni 1: Objekti*

**1.1** Me nenshkrimin e kesaj Marreveshje dhe sipas kushteve te percaktuara ne te, Barrëdhënësi **"Albesol" sh.p.k** sh.p.k. ne Vendimin e Asamblese te Ortakeve te Shoqerise Nr. ____ te dates ___/___/2018, vendos Barrë Siguruese ne favor te Barremarresit, nje pjese te kuotave, qe perfaqesojne 100% te kapitalit te shoqerise **"Albesol" sh.p.k**., si dhe te gjitha te drejtat dhe pretendimet lidhur me to ("Kuotat") me qellim sigurimin e çdo dhe te gjithe detyrimeve te Shoqerise "Albesol" sh.p.k qe rrjedhin nga **Kontrata e Kredise Nr. 2496 Rep, Nr. 380 Kol, date 21.04.2015** *(Notere Xhevahire Brahaj)*; **Kontrata e Kredise Nr. 4709 Rep, Nr. 1030 Kol, date 29.09.2016** *(Notere Xhevahire Brahaj);* **Kontrata e Kredise Nr. 483 Rep., Nr. 118 Kol., date 01.02 2018,** *(notere XH. BRAHAJ)*, te lidhura me Banken Kombetare Tregtare Sh.a – Dega "Rruga e Elbasanit" per kredine e marre duke perfshire por pa u limituar ne interesat, penalitetet dhe cdo shpenzim te kryer nga Kredimarresi per te permbushur ekzekutimin ne menyre te detyrueshme ("Kontrata e Kredise").

**1.2** Barredhenesi garanton Banken se Kuotat qe zoteron ne shoqerine "Albesol" sh.p.k, dhe qe do te barresohen ne favor te saj, jane te lira nga cdo barresim i meparshem, duke i paraqitur Bankes nje vertetim te leshuar nga Regjistri i Barreve Siguruese.

***Neni 2: Te drejtat dhe detyrimet***

**2.1** Barredhenesi ka rene dakort te barresoje kuotat qe zoteron ne shoqerine me pergjegjesi te kufizuar "Albesol" sh.p.k, ne masen 100% qe zoteron sipas te dhenave te Ekstraktit leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit.

**2.2** Banka pranon barren siguruese mbi 100% te Kuotave qe zoteron barredhenesi ne shoqerine "Albesol" sh.p.k , si garanci per kredine e levruar Debitorit "Albesol" sh.p.k sipas **Kontrata e Kredise Nr. 2496 Rep, Nr. 380 Kol, date 21.04.2015** *(Notere Xhevahire Brahaj)*; **Kontrata e Kredise Nr. 4709 Rep, Nr. 1030 Kol, date 29.09.2016** *(Notere Xhevahire Brahaj)*; **Kontrata e Kredise Nr.** 483 **Rep., Nr.** 11P **Kol., date** 01.02 **2018,** *(notere* XH. BRAHAJ *).*

**2.3** Barredhenesit autorizojne Banken qe ne rastin kur kredimarresi eshte me vonese te shlyerjes se nje apo me shume detyrimeve te rrjedhura nga Marreveshja e Kredise, te filloje procedurat per disponimin dhe zoterimin e kuotave te shoqerise ne masen 100% objekt i kesaj marreveshje, pa asnje paralajmerim dhe formalitet.

**2.4** Barredhenesit do te kryejne cdo veprim me ose pa kerkese te Bankes per te ruajtur barren siguruese nga veprimet sekuestruese te personave te trete si edhe prioritetin dhe te drejtat e Bankes mbi kuotat e shoqerise.

**2.5** Barredhenesi merr persiper qe te regjistroje Marreveshjen mbi barresimin e Kuotave ne (i) Regjistrin e Kuotave/Ortakeve si dhe (ii) ne Regjistrin Tregtar prane Qendres Kombetare te Biznesit. Barredhenesi do te vere ne dispozicion te Bankes vertetimet perkatese per regjistrimin e barres mbi Kuotat siç kerkohet me lart.

***Neni 3: Mbarimi i Barres Siguruese***

**3.1** Kuotat e vendosura si barre siguruese do te vazhdojne te mbeten te barresuara ne favor te Bankes, deri ne permbushjen ne menyre te plote dhe te parevokueshme, te te gjitha detyrimeve qe rrjedhin nga Marreveshja e Kredise, duke kryer njekohesisht edhe c`regjistrimin nga Regjistri i Barreve Siguruese.

***Neni 4: Dispozita te perbashketa***

**4.1** Palet mund te ndryshojne vetem me shkrim elementet e kesaj Marreveshjeje dhe ti pasqyrojne ato ne Regjistrin e Barreve Siguruese.

**4.2** Mosmarreveshjet e paleve zgjidhen me mirekuptim, ne te kundert kompetente do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

**4.3** Afati i vlefshmerise se kesaj Marreveshjeje perputhet me afatin e vlefshmerise se Marreveshjes se Kredise.

**4.4** Kjo Marreveshje Siguruese sipas legjislacionit shqiptare ne fuqi, perben titull ekzekutiv.

**4.5** Marreveshja nenshkruhet ne 5 kopje me vlere te njejte.

| **BARREMARRESI:** | **BARREDHENES:** |
|---|---|
| **BKT SH.A - DEGA "Rruga Elbasanit"** | **1. Shoqeria "Albesol" sh.p.k** |
| *Perfaqesuar nga:* | *Perfaqesuar nga:* |
| **1. Z. Sokol KACILA** | **Znj. Elona PULTI** |
| Sokol KAÇILA | Elona Pulti |
| **2. Znj. Elvira PRODA** | **2. Znj. Elona PULTI** |
| Elvira Proda | Elona Pulti |